



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Lënda: Njoftim për shpallje të vendit të punës

TIRANË

Instituti i Shëndetit Publik shpall pozicionin e punës si vijon:

- **Mjek/Specialist, Sektori i Sëmundjeve Kronike pranë Departamentit të Performancës Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike (1 Vend Pune)**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

- Mjeku do të lexoj dhe vlerësoj imazhet e mamografive të kryera nga njësitë e levizshme dhe jep rekomandime për ndjekje të mëtejshme për diagnozë.
- Leximi i rreth 5000 imazheve të mamografive në vit (interpretimi i imazheve të mamografive sipas BIRADS për të përcaktuar statusin shëndetësor të gruas).
- Të asistojë dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me teknikët e radiologjisë së njësitë të lëvizshme të mamografive për të rritur cilësinë e kryerjes së shërbimit.
- Organizimin e logjistikës së kalendarit të lëvizjeve të njësitë të mamografive etj.

Kandidati për vendin e punës **“Mjek/Specialist, Sektori i Sëmundjeve Kronike pranë Departamentit të Performancës Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike”** duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë, dega Mjekësi e Përgjithshme;
2. Të ketë Diplomë Specializimi në Imazheri;
3. Të ketë eksperiencë pune në fushën e diagnozave me imazhe;
4. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
6. Të ketë aftësi komunikuese dhe të punuarit në grup;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë, do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- Motivimin në punë, personalitetin, njohjen e gjuhëve të huaja, aftësinë komunikuese;

Mënyra e vlerësimit:

Kandidatët do të vlerësohen bazuar në **Urdhërin Nr.511, datë 13.12 2011** “Për kriteret e Punësimit në Shërbimin Shëndetësor Publik” të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përcaktimet vlerësuese:

Nota mesatare

Mbi 9 vlerësohet me 15 pikë

Mbi 8 vlerësohet me 12 pikë

Mbi 7 vlerësohet me 8 pikë

Mbi 6 vlerësohet me 4 pikë

Mbi 5 vlerësohet me 2 pikë

Grada apo titulli shkencor/specializim vlerësohet me 20 pikë

Gjuha e huaj e vërtetuar vlerësohet 3 pikë

Përvoja mbi 10 vjet vlerësohet 5 pikë

Intervista (maksimalisht) vlerësohet 10 pikë

✓ Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Protokollit në Institutin e Shëndetit Publik këto dokumenta:

1. **Kërkesë me shkrim për aplikim;**
2. **Jetë shkrimin (CV);**
3. **Fotokopjetë pasaportës ose kartës së identitetit;**
4. **Kopje e noterizuar e diplomës, bashkë me listën e notave të noterizuara;**
5. **Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);**
6. **Kopje e noterizuar e çertifikatë/dëshmi që vërteton njohuritë programit të paketës MicrosoftOffice;**
7. **Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes një nga gjuhët e huaja perëndimore (Anglisht,Frëngjisht, Italisht);**
8. **Vërtetimi gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);**
9. **Dëshmi Penaliteti të marrë brenda tre muajve të fundit;**
10. **Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;**
11. **Formulareve të deklaramit sipas formës së kërkuar nga ligji nr. 138/2015;**
12. **Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;**
13. **Vërtetim nga punëdhënësi mëparshëm (i fundit) që nuk ka masë disiplinore;**
14. **Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, që provojnë vlerësimet positive në punë;**
15. **Leja e ushtrimit të profesionit (nëse ka);**
16. **Certifikate familjare dhe vërtetim banimi;**

Pranimi i dokumentave në Institutin e Shëndetit Publik është **deri në datën 10 Qershor 2026**(përfshirë edhe dt.10.06.2026).

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit të sipërcituar brënda afatit të përcaktuar në shpallje, sjell skualifikimin e kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta. Për çdo paqartësi mund të dërgoni email në adresën ishp@shendetesia.gov.al.

Ju faleminderit,

DREJTOR

Dorina Toçi